

## SHËRBIMET E SIGURISË DHE MBIKËQYRJA PARLAMENTARE

Nga Xhavit Shala

Tronditjet e rënda të sigurisë publike me datën 21 janar 2011 përbëjnë njëkohësisht një kërcënim të jashtëzakonshëm jo vetëm për sigurinë kombëtare të Shqipërisë por dhe për gjeopolitikën dhe sigurinë e gjithë shqiptarëve ne rajonin e Ballkanit.<sup>1</sup> Natyrshëm, në situata të tilla, vëmendja drejtohet tek shërbimet e sigurisë së vendit. Taksapaguesit shqiptar janë të interesuar për tu informuar për efikasitetin e punës së operatorëve të fushës së sigurisë, në përmbushjen e detyrimeve të tyre ligjore sipas drejtimeve, jo vetëm për atë që ndodhi me 21 janar 2011, por dhe për të paralajmëruar, parandaluar dhe neutralizuar kërcënime të ngjashme për sigurinë kombëtare të vendit ne të ardhmen. Këto informacione, taksapaguesit dhe votuesit shqiptar mund t'i sigurojnë edhe nëpërmjet mbikëqyrjes parlamentare të shërbimeve të sigurisë.

Në dekadat e fundit ka pasur një sensibilitet në rritje i cili ka çuar në arritjen e një konsensusi ndërkombëtar për çështjen e mbikëqyrjes demokratike të shërbimeve në fushën e sigurisë. Organizata ndërkombëtare të tilla si Organizata për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD), Kombet e Bashkuara, Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, Unioni Ndër-Parlamentar etj, të gjitha në mënyrë të hapur e pranojnë se shërbimet në fushën e sigurisë duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes parlamentare.

Në të vërtetë mbikëqyrja parlamentare në këtë fushë është një fenomen i kohëve të fundit edhe në demokracitë e qëndrueshme. Pikërisht në mesin e viteve shtatëdhjetë shfaqen rastet e para të fillimit të demaskimit të shpërdorimeve nga ana e agjencive të fshehta të sigurisë. Pas Shteteve të Bashkuara në vitin 1979, Australisë dhe Kanadasë në vitin 1984, një seri vendesh demokratike nxorën ligje në favor të mbikëqyrjes së shërbimeve të sigurisë.

Parlamenti është në themel të demokracisë dhe shërben si mburojë kundër sundimit autokratik. Në një shtet demokratik nuk duhet të këtë fusha të veprimtarisë shtetërore jashtë mbikëqyrjes parlamentare. Qeverisja e mirë kërkon mbikëqyrje parlamentare. Edhe veprimtaria në fushën e sigurisë, si veprimtari shtetërore, nuk mund të përjashtohet nga ky rregull. Mbikëqyrja parlamentare kontribuon për të garantuar që operatorët në fushën e sigurisë respektojnë, zbatojnë dhe mbrojnë kushtetutën. Pjesëmarrja e parlamentit në mbikëqyrjen e fushës së sigurisë është një garanci që këta operatorë i shërbejnë shtetit në tërësi dhe jo interesave më të ngushta politike apo partiake. Gjithashtu është parlamenti institucioni që krijon kornizën ligjore për çështje të sigurisë. Ai në të

---

<sup>1</sup> Shkrimi është botuar në të përditshmen "Koha Jonë" me datë 2.2.2011.

njëjtën kohë mban fuqinë e “kuletës” duke përcaktuar buxhetin për financimin e operatorëve në fushën e sigurisë.

Por çfarë kuptojmë me mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe cilat janë kushtet dhe mekanizmat për realizimin e saj? Cila është praktika botërore dhe ajo shqiptare në këtë fushë? Cilët janë kufijtë e mbikëqyrjes parlamentare në shërbimet e sigurisë dhe a duhet organi i mbikëqyrjes parlamentare (komisioni) të ketë kompetencë të mjaftueshme për të këqyrur apo hetuar informacione dhe dokumente nga këto shërbime?

### **1. Kuptimi mbi mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe kushtet për realizimin e saj.**

Përgjithësisht, mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë varet nga kompetencat që ka parlamenti në lidhje me ekzekutivin dhe shërbimet e sigurisë. Kompetencë në këtë fushë do të thotë mundësia për të ndikuar në zgjedhjet dhe qëndrimin e ekzekutivit e të shërbimeve të sigurisë, në përputhje me vullnetin kolektiv të popullit, siç është shprehur në parlament. Ajo gjithashtu përfshin mundësinë për të mbikëqyrur zbatimin e politikave, legjislacionit, vendimeve dhe buxhetit, siç janë miratuar nga parlamenti.

Ndonëse fshehtësia është një kusht i nevojshëm i punës në fushën e sigurisë, sidomos kjo për shërbimet e fshehta të informacionit, në një vend të demokracisë liberale operatorët në fushën e sigurisë duhet të punojnë brenda kuadrit të shtetit ligjor, mbikëqyrjes, balancimit dhe linjave transparente të përgjegjësisë.

Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë përfshin detyrimin e përfaqësuesve të ekzekutivit apo të punonjësve të shërbimeve të sigurisë, qofshin të zgjedhur apo të emëruar, për të dhënë llogari para parlamentit në lidhje me ushtrimin e kompetencave dhe detyrave të tyre. Qëllimin politik i mbikëqyrjes parlamentare në këtë fushë është mbikëqyrja dhe minimizimi i shpërdorimit të pushtetit nga ana e institucioneve, agjencive dhe shërbimeve të sigurisë, qofshin këto brenda apo jashtë ekzekutivit. Ndërsa qëllimi taktik i mbikëqyrjes parlamentare është që të kontribuojë për të siguruar efikasitetin e këtyre operatorëve për përmbushjen e detyrimeve ligjore sipas drejtimeve.

Shpesh në vend të termit “mbikëqyrje parlamentare” përdoret termi “kontrolli parlamentar”. Por, të bësh kontroll do të thotë të drejtosh, të jesh përgjegjës, të jesh i aftë të drejtosh dhe të ushtrosh ndikim mbi një detyrë të caktuar të operatorëve në fushën e sigurisë, çka nuk është kompetence e parlamenteve por ekskluzive e vetë operatorëve në fushën e sigurisë. Ndërsa mbikëqyrja është një koncept më i përgjithshëm se kontrolli, meqenëse ajo nuk nënkupton se një “mbikëqyrës” i supozuar drejton ose ka aftësinë për të pasur ndikim në vendimmarrje ose në përfundimet e operatorëve në fushën e sigurisë. Rishikimi i punës së këtyre operatorëve bëhet nga monitorimi i fakteve që rrjedhin prej punës së tyre dhe i statusit ligjor, përcaktues të veprimeve të tyre.

Kompetenca për mbikëqyrjen parlamentare buron nga kushtetuta, ligjet si dhe rregullat e procedurale parlamentare. Ndërsa kushtet për një mbikëqyrje efektive parlamentare në fushën e sigurisë janë:

- Kompetencat kushtetuese dhe ligjore të përcaktuara qartë.
- Ekspertizë dhe burime të nevojshme brenda parlamentit ose në dispozicion të tij.
- Përvoje dhe praktikë në mbikëqyrjen parlamentare të mbështetura në normat shoqërore siç është respekti dhe besimi i ndërsjellë.
- Vullnet politik të parlamentarëve për të përdorur mjetet dhe mekanizmat që kanë në dispozicion për një shqyrtim të hollësishëm efektiv të fushës së sigurisë.

## **2. Mekanizmat parlamentare që zbatohen në fushën e sigurisë.**

Të gjitha sistemet ligjore u sigurojnë parlamenteve një shumëllojshmëri mjetesh për thithjen e informacionit për të kontrolluar politikën, për të mbikëqyrur administratën, për të mbrojtur individin e për të eliminuar padrejtësitë. Parlamentarët, përveç kësaj, mund të përfitojnë ose të krijojnë praktika të mira dhe metoda jozyrtare që plotësojnë këto mjete dhe mekanizma kushtetuese apo ligjore. Parlamentet kanë tri mundësi të zakonshme ligjore për të marrë informacion për çështjet e sigurisë :

- debatet parlamentare;
- pyetjet dhe interpelancat parlamentare;
- hetimet parlamentare

**2.1. Debatet parlamentare për çështjet e sigurisë** krijojnë një mundësi të rëndësishme për të shkëmbyer mendime dhe për të grumbulluar informacion thelbësor rreth çështjeve të sigurisë. Debatet parlamentare për politikën dhe çështjet e sigurisë përgjithësisht mund të zhvillohen në disa situata e konkretisht: pas paraqitjes nga ana e ekzekutivit të propozimeve për buxhetin vjetor të operatoreve të sigurisë; pas deklaratave zyrtare ose jozyrtare të titullarëve përkatës, si ministri i mbrojtjes, ministri i punëve të jashtme, ministri i brendshëm dhe shefit të shërbimit sekret; në momentet e rishikimit të strategjive të sigurisë kombëtare e të dokumenteve të tjera të rëndësishme për mbrojtjen kombëtare; gjatë paraqitjes së programeve qeverisëse, pjesa për sigurinë; për çështjet e veçantë që kërkojnë debat parlamentar, si në rastin e ndonjë skandali, në rastet e cenimeve të rënda të rendit dhe sigurisë siç ndodhi në Shqipëri me 21 janar 2011; apo në rastin e katastrofave humanitare etj.

**2.2. Pyetjet dhe interpelancat parlamentare** mund të kontribuojnë në mënyrë të konsiderueshme për një mbikëqyrje efektive të fushës së sigurisë, duke pasur parasysh funksionin thelbësor që ato kryejnë. Pyetjet parlamentare në lidhje me sigurinë në përgjithësi i krijojnë mundësinë deputetëve që të përftojnë në kohë informacion të saktë dhe të fundit në lidhje me politikën e qeverisë për mbrojtjen dhe sigurinë dhe për çështjet e sigurisë në përgjithësi; ndihmojnë parlamentin që të ushtrojë kontroll për zbatimin e ligjeve të miratuara prej tij, të cilat lidhen me sigurinë; ndihmojnë që vëmendja e publikut të përqendrohet tek çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë, sidomos kur pyetjet bëhet me gojë dhe përgjigja transmetohet në radio ose televizor; sigurojnë informacion për një publik më të gjerë, duke përfshirë mediat, OJQ-të dhe shoqërinë civile në tërësi; mund të jenë

të dobishme për të riorientuar kalendarin politik të ekzekutivit për çështjet e sigurisë; u japin mundësi anëtarëve të opozitës të ngrenë probleme për çështjet e sigurisë të cilat përbëjnë shqetësim për ta. Shpesh, shumica e pyetjeve parlamentare në lidhje me fushën e sigurisë janë shumë të ndjeshme. Dokumentet që lidhen me sigurinë kombëtare janë shpeshherë të klasifikuara dhe për këtë arsye nuk u vihen në dispozicion parlamentarëve e as mjeteve të informimit. Ky shqetësim mund të zbutet nëpërmjet komisioneve parlamentare.

**2.3. Komisionet e përkohshme hetimore për çështjet e sigurisë/mbrojtjes** kanë rëndësi të veçantë. Epërsitë e tyre janë të shumta e konkretisht: ngritja e tyre mund të shihet, sidomos nga publiku, si një sinjal pozitiv politik; ato mund të jenë një mjet i përshtatshëm për të shqyrtuar në mënyrë të hollësishme çështje politikisht të ndjeshme që lidhen me fushën e sigurisë; bëjnë të mundur vlerësimin e përpiktë të politikës së qeverisë për çështje të veçanta të sigurisë dhe propozojnë mjetet e korigjimit ose riorientimit, të cilat kur miratohen, përgjithësisht pranohen nga i gjithë parlamenti dhe qeveria.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i këtyre komisioneve është përbërja e tyre. Pjesëmarrja dhe raporti në numër i deputeteve të opozitës në këto komisione është mjaft i rëndësishëm. Kompetencat e hetimit ndryshojnë ndjeshëm nga njëri parlament tek tjetri dhe nga njëri komision tek tjetri. Kompetencat thelbësore përfshijnë kryesisht të drejtën: për të zgjedhur temën dhe objektin e hetimit parlamentar; për të bërë vizita në bazat e ushtrisë dhe në selitë e tjera të shërbimeve të sigurisë; për të grumbulluar të gjithë informacionin përkatës, duke përfshirë dokumentet e klasifikuara dhe tepër sekret, nga presidenca, administrata qeveritare ose shtabi i përgjithshëm; për të marrë dëshmi me betim nga anëtarët e presidencës, të administratës qeveritare ose të forcave të armatosura si dhe të shoqërisë civile. etj. Megjithatë edhe këto komisione janë të limituara në kohë, ndërkohë që ndjeshmëria për çështjet e sigurisë është e përhershme. Dhe zgjidhja për këtë janë komisionet e përhershme parlamentare.

**2.4. Komisionet e përhershme parlamentare të mbrojtjes/ sigurisë dhe detyrat e tyre.**

Nëse parlamenti kërkon të ushtrojë vërtet një mbikëqyrje cilësore në fushën e sigurisë, nisur dhe nga specifikat e kësaj fushe, është me rëndësi vendimtare që mbikëqyrja parlamentare të ketë një strukturë të zhvilluar dhe permanente. Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë përfshin jo thjesht një komision, por disa komisione, që në parlamente të ndryshme mund të thirren me emra të ndryshëm dhe shpesh me mandate të përziera. Në praktikën parlamentare të vendeve të ndryshme ndeshen komisionet e mëposhtme:

- Komisioni i mbrojtjes (që nganjëherë quhet komisioni i forcave të armatosura ose komisioni i mbrojtjes dhe i sigurisë kombëtare ose komisioni i sigurisë dhe i punëve të jashtme), i cili përgjithësisht merret me të gjitha çështjet që lidhen me fushën e sigurisë, si misionin, organizimin, personelin, operacionet dhe financimin e forcave të armatosura, si dhe me rekrutimin dhe prokurimin;

- Komisioni i punëve të jashtme që trajton, për shembull, vendimet për

pjesëmarrjen në misionet e paqes ose për pranimin e tyre në territorin kombëtar, si dhe sigurinë ndërkombëtare, organizatat, traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare/rajonale;

- Komisioni i buxhetit ose i financave, i cili luan rolin kryesor në përcaktimin e buxhetit për të gjithë operatorët në fushën e sigurisë; ndoshta komisioni i llogarive publike që rishikon raportet e kontrollit për të gjithë buxhetin kombëtar, duke përfshirë buxhetin e mbrojtjes;

- Komisioni (ose nën komisioni) i çështjeve të shërbimeve të fshehta të informacionit, i cili shpeshherë bën mbledhje me dyer të mbyllura;

- Komisioni i industrisë dhe tregtisë, i cili është veçanërisht i rëndësishëm për çështjet e prokurimit dhe tregtisë së armëve; Komisioni i shkencës dhe teknologjisë (për kërkime ushtarake dhe zhvillimin);

- Komisioni i brendshëm (ose i punëve të brendshme) që merret me policinë, rojat kufitare dhe shpeshherë organizime të tjera paraushtarake.

### **3. Praktika shqiptare e komisioneve në fushën e sigurisë.**

Në Kuvendin e Shqipërisë, në zbatim të nenit 19 të Rregullores, janë ngritur dhe funksionojnë tetë komisione të përhershme parlamentare. Fusha e sigurisë është ekskluzive e Komisioni për Sigurinë Kombëtare. Ai mbikëqyr organizimin e mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimin ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendin publik dhe shërbimet sekrete. Ndërsa në Kuvendin e Kosovës çështjet e sigurisë mbulohej nga Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri.

Detyra kryesore të komisionit parlamentar për çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë mund të jenë në këto fusha: Politikat e sigurisë, legjislacioni, shpenzimet/buxheti si dhe menaxhimi e administrimi.

Lidhur me politikat e sigurisë: Komisioni përhershëm duhet të verifikojë dhe të raportojë për çdo nismë të rëndësishme që shpall ministria e mbrojtjes e ajo e brendshme në lidhje me politikat e sigurisë; të marrë në shqyrtim në mënyrë periodike ministrinë e mbrojtjes, ministrinë e brendshme dhe agjencitë e sigurisë për kryerjen e përgjegjësive të tyre porsa i përket politikës; ti mbaje ato nën vëzhgim për përputhshmërinë me legjislacionin për lirinë e informacionit dhe cilësinë e dhënies së informacionit për parlamentin me çfarëdo mjeti; të verifikojë kërkesat dhe ankesat e personelit të tyre në lidhje me fushën e sigurisë.

Lidhur me legjislacionin: Komisioni duhet të raportojë për çdo projektligj që propozon qeveria dhe që i referohet atij nga parlamenti; të shqyrtojë traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare ose rajonale që përfshihen në fushën e përgjegjësive të ministrisë së mbrojtjes, ministrisë brendshme dhe agjencive të sigurisë; sipas rastit, të iniciojë legjislacion të ri, duke kërkuar që ministrinë të përkatëse apo agjencitë e sigurisë të propozojë një ligj të ri, ose ta hartojë vetë atë.

Lidhur me shpenzimet: Komisioni duhet të kontrollojë dhe të raportojë për vlerësimet kryesore dhe shpenzimet vjetore të ministrive dhe agjencive të fushës së sigurisë; të shqyrtojë çdo vlerësim suplementar që paraqesin ato dhe të raportojë në parlament sa herë që ato kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm; sipas

rastit, të urdhërojnë autoritetet kompetente të kryejnë kontroll.

Lidhur me menaxhimin dhe administrimin: Komisioni duhet të shqyrtojë dhe, sipas rastit, të mbajë shënim dhe të raportojë për çdo emërim të rëndësishëm që bën autoriteti përkatës ekzekutiv (komandantë ushtarakë kryesorë, nëpunës civilë të lartë); Të shqyrtojë organizimin e brendshëm të fushës së mbrojtjes dhe ta tërheqë vëmendjen e parlamentit në rast mosfunksionimi etj.

Por a është e limituar mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë? Deri ku shtrihet ajo dhe cilat janë sfidat që duhen përballuar?

#### **4. Kufijtë e mbikëqyrjes parlamentare në fushën e sigurisë.**

Në shumicën e demokracive, parlamentet kanë mandat të gjerë mbi shërbimet e sigurisë. Por, këto mandatet ndryshojnë shumë nga njëri vend tek tjetri. Në këtë pikë, shtete të ndryshme demokratike kanë praktike të ndryshme. Dallimet ekzistojnë në masën në të cilën organet e mbikëqyrjes hyjnë në hollësi operative.

Nëse marrim si rast studimor praktikat e mbikëqyrjes parlamentare për dislokimin e forcave ushtarake jashtë vendit të Kanadasë, Çekisë, Danimarkës, Francës, Gjermanisë, Hungarisë, Maqedonisë, Holandës, Polonisë, Rumanisë, Spanjës, Zvicrës, Suedisë, Turqisë, Britanisë, SHBA dhe Shqipërisë, do të vërejmë se nga 17 vendet objekt studimi, vetëm 4 prej tyre ose rreth 23%, kanë pranuar si praktikë mbikëqyrjen parlamentare në çështje operationale. Ndërsa 12 vende ose rreth 70% e tyre praktikojnë aprovimin paraprak për dislokimin e forcave ushtarake jashtë vendit.

Nëse marrim si rast studimor mbikëqyrjen parlamentare të shërbimeve inteligjente në tre shtete demokratike model, Gjermaninë në Evropë, Australinë në lindje të globit dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës në perëndim të tij do të vërejmë se dy nga këto tre shtete me demokraci model, aplikojnë një mbikëqyrje të plotë parlamentare mbi shërbimet e fshehta.

Kështu, Bundestag-u gjerman ka mandatuar grupin e vet të mbikëqyrjes parlamentare për të shqyrtuar në mënyrë të hollësishme si drejtimet politike ashtu edhe operationet. Drejtimet politike përfshijnë procedurat që e mundësojnë shërbimin e fshehtë për të vepruar dhe për të përmbushur detyrat e tij. Grupi gjerman i Kontrollit Parlamentar është plotësisht i informuar për të dyja këto procedura dhe zbatimin e tyre. Përveç kësaj, Grupi gjerman i Kontrollit Parlamentar duhet të informohet për operationet e shërbimeve të fshehta të informacionit, si dhe për aspekte të lidhura me shërbimin e fshehtë që pasqyrohen në media. Për më tepër, Grupi i Kontrollit duhet të jetë plotësisht i informuar për vendimet e rëndësishme që ndryshojnë procedurat e brendshme të agjencive.

Edhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës parashikojnë se ekzekutivi e ka përgjegjësinë për t'i mbajtur të informuara komisionet për shërbimin e fshehta. Gjithashtu dhe vet autoritetet e shërbimeve të fshehta e kanë detyrimin t'u japin komisioneve për shërbimin e fshehtë çdo informacion ose material në lidhje me veprimet e fshehta.

Ndërsa në Australi, Komisionit Parlamentar i ndalohet të kërkojë deklarin e "informacione që do të cenonin ose mund të cenonin sigurinë kombëtare të Australisë ose zhvillimin e marrëdhënieve me jashtë të Australisë" si dhe "informacionit të ndjeshëm nga pikëpamja operative" Komisioni nuk mund t'i bëjë kërkesa për dokumente krerëve të agjencive dhe " ministrat mund të vënë veton që të mos jepen të dhëna".

### **5. Përfundime e rekomandime**

Në një shtet demokratik nuk duhet të këtë fusha të veprimtarisë shtetërore jashtë mbikëqyrjes parlamentare. Edhe veprimtaria në fushën e sigurisë, si veprimtari shtetërore, nuk mund të përjashtohet nga ky rregull. Po cila do të ishte zgjidhja me optimale për demokracitë e reja siç është vendi ynë? Fakti që shtete me demokraci shekullore të konsoliduar e kanë ndjerë domosdoshmërinë e mbikëqyrjes parlamentare në fushën e sigurisë, na bën të besojmë se kjo mbikëqyrje në këtë fushë është shumë më e domosdoshme në demokracitë e reja. Kjo sepse për shumë arsye, mundësitë e abuzimit të këtyre shërbimeve janë më të mëdha. Por, duke qenë demokraci të pa konsoliduara plotësisht, me pengesa ligjore lehtësisht të kapërcyeshme për depërtimin në parlament edhe të lidhjeve të kimit të organizuar, ekziston mundësia e rrezikimit të informacionit të klasifikuar dhe të vetë burimeve të informacionit të operatorëve të sigurisë.

Ky rrezik mund të minimizohet duke vendosur me ligj që anëtarët e komisionit të mbikëqyrjes parlamentare të shërbimeve të sigurisë, të verifikohen në rastet kur mandati i komisionit përfshin trajtimin e materialeve të ndjeshme nga pikëpamja operative. Kriteret e verifikimit duhet të jenë të qarta, publike, të besueshme dhe të forta me qëllim që t'i bëhet ballë shqyrtimit të hollësishëm demokratik. Gjithashtu duhet të krijohet procedura për rastet mosmarrëveshjeve kur anëtarëve të parlamentit u mohohet miratimi nga ana e shërbimeve të sigurisë, duke i dhënë parlamentit ose kryesisë së tij të drejtën e vendimit përfundimtar. Gjetja e një ekuilibri midis domosdoshmërisë por edhe të rrezikut të mundshëm të një mbikëqyrjeje të hollësishme parlamentare në fushën e sigurisë është shenjë pjekurie e politikës dhe demokracisë së vendit, por edhe e emancipimit dhe profesionalizmit të agjencive të sigurisë.

Gjithsesi, për të rritur efikasitetin dhe standardet e mbikëqyrjes parlamentare në fushën e sigurisë, do të ishte e rekomandueshme:

- Hartimi i një legjislacioni që garanton pavarësinë, funksionin dhe vlefshmërinë e instrumenteve të përshtatshëm për institucionet demokratike që të mbikëqyrin fushën e sigurisë. Parlamentarët duhet të sigurohen që institucioni mbikëqyrës ka të drejta të plota ligjore për të vëzhguar, hetuar dhe raportuar mbi aktivitetet e operatorëve të sigurisë.

- Hartimi i politikave të ekuilibruara dhe procedurave me terma të qarta për mënyrën e ushtrimit të aktivitetit të komisioneve të mbrojtjes, shërbimit informativ dhe agjencive të zbatimit të ligjit, të mbështetur mbi parimet e transparencës dhe llogaridhënies. Krijimi i komisioneve apo nën komisioneve të specializuara për t'u marrë me secilin operator të fushës së sigurisë. Hartimi i

rregullave e procedurave efektive për secilin komision duke përfshirë dhe të drejtën për të thirrur çdo zyrtar të qeverisë në mbledhjet e komisionit dhe për ta pyetur atë nën betim si dhe të drejtën për të pasur akses në informacionin e klasifikuar.

- Inkurajimi i unitetit parlamentar mbi çështje të mbikëqyrjes parlamentare në sektorin e sigurisë.
- Kualifikimi dhe përdorimi i stafeve të përhershme të ekspertëve brenda komisioneve parlamentare, për të punuar së bashku me to për çështje të parlamentit dhe për t'u këshilluar mbi aspektet e mbikëqyrjes demokratik në fushën e sigurisë.
- Transparencë në emërimet e zyrtarëve të lartë në fushën e sigurisë nëpërmjet ratifikimit parlamentar.

Tirane 2.2.2011